USAID | MACEDONIA
FROM THE AMERICAN PEOPLE

PRESS RELEASE

PËR QARKULLIM TË MENJËHERSHËM
28 nëntor, 2007
Zyra për shtyp: +389 (0)2 308-0446
Celulari: +389 (0)70 367 547
Email: bvelickovska@usaid.gov

USAID dhe donatorë të tjerë kremtojnë rinovimin e shkollës Nikolla Karev dhe i japin respekt nxënësit legjendar të kësaj shkolle– Toshe Proeski

Populli amerikan, përmes një bashkëpunimi mes Projektit për arsim fillor (PEP), Qeverisë së Maqedonisë, Komunës së Krushevës, Peace Corps dhe donatorëve të tjerë, kremtoi renovimin e suksesshëm të shkollës Nikolla Karev në Krushevë. Ky projekt – i cili përfshiu instalimin e dritareve të reja të aluminit të cilat kursejnë energji, dhe renovimin e fasadës shkollore – shënon fundin e fazës së parë të rinovimeve nga ana e projektit PEP.

"Vetëm këtë vit, pothuajse 500 nxënës dhe personeli shkollor do të kenë dobi nga ky projekt. Mijëra të tjerë do të kenë dobi në të ardhmen," tha Ambasadorja e ShBA-ve Xhillian Millovanoviç në ceremoninë e prerjes së shiritit. "Këtu në Krushevë, dhe veçanërisht në shkollën Nikolla Karev, e di se të gjithë jemi duke menduar për Toshe Proeskin– një artist i madh dhe një humanitar i madh. Në një mënyrë, e di se ai sot është me ne," tha Millovanoviç.

Zëvendës kryeministri Zhivko Jankulovski dhe kryetari i komunës së Krushevës, Lefkija Gazoska, gjithashtu falënderuan Toshe Proeskin dhe punën e tij humanitare në mbështetje të arsimit në Maqedoni. Si pjesë e ceremonisë, mysafirët e nderit, mbollën një pemë të qershisë në oborrin shkollor në nder të Toshes.

Ky projekt shënoi përfundimin e suksesshëm të fazës së parë të rinovimeve të shkollave të PEP, gjatë së cilës tetë shkolla, morën nga afro 30 000 dollarë secila nga USAID-i, për përmirësime të infrastrukturës, me komuna të cilat po sigurojnë kontribute gjithashtu. Projekti do të rinovojë deri në 100 shkolla fillore gjatë katër viteve të zbatimit të projektit.

SHËNIM PËR REDAKTORËT:

Populli amerikan, përmes USAID, ka investuar afro 500 milionë dollarë në Maqedoni që nga viti 1993. USAID po zbaton projekte të cilat po krijojnë vende të reja të punës, zvogëlojnë korrupsionin dhe përgatisin studentët e Maqedonisë për fuqi pune. Këto nisma përmirësojnë cilësinë e jetës dhe përkrahin kalimin e Maqedonisë kah një demokraci e qëndrueshme. USAID siguron ndihmë ekonomike dhe humanitare në më shum[se 100 vende. Për më tepër informata ju lutemi vizitoni http://macedonia.usaid.gov.